



**AKT THEMELIM DHE STATUT**

**I**

**SHOQERISE ME PERGJEGJESI TE KUFIZUAR**

**TIRANA BUSINESS CONSULTING SHPK**

**SHPK**

Sot ne Tirane me date 03.10.2018 para meje noterit Publik Saimi S. Shaliku paraqit personalisht Z. Ibrahim Elfaki, shteteas Sudanes i biri i Muhamedit dhe i Nureisham, lindur ne Omdurman me 06.09.1968 , banues ne Tirane, me zotesi te plote per te vepruar, mbajtes i pasaportes me Numer. **P02399858**, per identitetin e te cilit u sigurova nga dokumentat personale, i asistuar nga perkthyesja Znj. Eniela Agolli, qe kerkoi hartimin e ketij Akt Themelmi dhe Statuti te shoqerise me pergjegjesi te kufizuar ne perputhje me ligjin shqiptar dhe me dispozitat si me poshte:

**Neni 1**

**Emertimi i shoqerise**

- 1.1 Shoqeria e emertuar Tirana Business Consulting shpk neshte nje shoqeri me pergjegjesi te kufizuar dhe ekziston ne perputhje me legjislacionin e Republikes se Shqiperise.
- 1.2 Shoqeria eshte themeluar sipas ligjit Nr.9901 date 14.04.2008 "Per tregtaret dhe shoqerite tregtare" dhe fiton personalitet juridik pas regjistrimit te saj ne rregjistrin tregtar te mbajtur prane Qendres Kombetare te Rregjistrimit (QKR)

**Neni 2**

**Selia**

2.1 Selia e shoqerise ndodhet ne Tirane ne adresen: Rruga e Kavajes Shkalla 1, kati 3, apartamenti 5, Nr. Pasurie 4/245+1-5, vol 14, fq 166, ZK 8250.

2.2. Shoqeria mund te hape zyra perfaqesimi, dege dhe /ose filial, te marre pjese ne shoqeri te tjera, te kryeje aktivite ne vende te tjera qofte Brenda apo jashte territorit te republikes se shqiperise, ne perputhje me vendimet e Asamblese se Pergjithshme te Ortakeve qe mund te miratohen here pas here.

**Neni 3**

**Kohezgjatja**

Kohezgjatja e veprimtarise se shoqerise Tirana Business Consulting shpk do te jete e pakufizuar. Asambleja e ortakeve mund ta kufizoje ose ta zgjase afatin e veprimtarise se Shoqerise.

**Neni 4**

**Objekti i Shoqerise**

4.1 Shoqeria ka per object te veprimtarise se saj kryerjen e cdo veprimtarie te lejuar nga ligji dhe /ose pjesmarrjen ne cdo veprimtari apo aktivitet te ligjsjem qe mund te kryeje nje shoqeri me pergjegjesi te kufizuar e krijuar ne baze te legjislacionit shqiptar dhe ne vecanti:

Objekti i aktivitetit te Shoqerise do te perfshije:

- a) Ofron analiza te situates ekzistuese te biznesit te kompanive dhe ben rekomandime per permiresimin ne te ardhmen;
- b) Jep konsulence per kompanite e vogla te mesme dhe te medha ne Shqiperi dhe ne Ballkan per hartimin dhe implementimin e Planeve te biznesit, planeve te marketingut , Studimeve te fizibilitetit.
- c) Kryen kerkime dhe studime te tregut, prezantime dhe perfaqesime te kompanive, sherbime komisionere, trajtime ne fushen e menaxhimit, marketingut, shitjes, burimeve njerezore ,menaxhimit te biznesit;
- d) Krijon partneritet te kompanive shqiptare me ato te huaja;
- e) Mundeson trajnime konsulence dhe informacion per menaxhimin e biznesit, marrdheniet me publikun dhe qeverine.
- f) Kryen cdo lloj konsulence te cdo lloj aktiviteti ne Shqiperi apo jashte saj qe lidhet me menyren e drejtperdrejte me objektin e aktivitetit te kompanive qe eshte e nevojshme per promovimin e biznesit dhe arritjen e qellimeve te Shoqerise.
- g) Kryen aktivitet ne median e shkruar, vizive dhe reklame mediatike etj,
- h) Themelon dhe merr pjese ne shoqeri te tjera qe ekzistojne ose jane ne krijim me te nejtin objekt si dhe pjesmarrja ne konsorciume ( join vendure) se bashku me persona te tjere fizike dhe juridik, per realizimin e objektit si me siper ose cdo object tjetet te ngjashem.

4.2 Shoqeria ka te drejte te hipotekoje, lere peng ose vere cdo barre tjetet mbi asetet qe do te krijohen per zbatimin e objektit te Shoqerise te lidhe cdo marrveshje financimi me cdo pale financuese, me kusht qe hipoteka, pengu apo barre te tjera po ashtu dhe marreveshje financiare perkatese qe sherbejne per te permbushur detyrimet e percaktuara ne objektin e Shoqerise.

#### **Neni 5 Kapitali**

Kapitali themeltar i regjistruar i shoqerise eshte 1000 (njemije) lek I perfaqesime 1 (nje) Kuote me vlere 1000 (njemije) Lek.

Ky capital mund te rritet ne baze te modaliteteve ligjore.

Kapitali eshte nenshkruar dhe shlyer teresisht nga ortakut i vetem.

#### **Neni 6 Trasferimi i kuotave**

Kuotat e kapitalit dhe te drejtat qe rrjedhin prej tyre jane te trasferueshme dhe mund te trasferohen ne cdo kohe sipas kushteve dhe afateve te parashikuara nga legjislacioni shqiptar dhe ky akt themelimi.

#### **Neni 7 Kompetencat e Ortakut te Vetem**

##### 7.1 Funkzioni dhe kompetencat

7.1.1 Ne perputhje me legjislacionin shqiptar, Asambleja e Pergjithshme e Ortakeve e thirrur rregullisht, perbehet nga ortaku i vetem i saj Z. Ibrahim Elfaki dhe ne perputhje me legjislacionin shqiptar, eshte pergjegjes per te marre vendime e meposhtme por pa u kufizuar vetem ne to:

- a) Percaktimin e politikave te biznesit;
- b) Emerimin dhe shkarkimin e Administratorit/ve;
- c) Emerimin dhe shkarkimin e likujduesve dhe eksperteve kontabel;
- d) Ritjen dhe zvogelimin e kapitalit te shoqerise;
- e) zbatimin dhe miratimin e pasqyrave financiare per llogaritje, te administrimit dhe te raporteve te mbikqyrjes;
- f) Miratimin e rregullave procedurale ne lidhje me mbledhjen e Asamblese se Ortakeve;
- g) Miratimin e shperndarjes se fitimit vjetor;
- h) Miratimin e skemes se kompensimit per Administratorin, Likujduesin dhe ekspertin kontabel;
- i) Ristrukturim, prishjen, trasformimin, bashkimin, likujdimin e shoqerise ose riorganizimin e Shoqerise ne ndonjr forme tjeter shoqerie;
- j) marrjen e te gjitha masave me qellim qe te sigurohet qe shoqeria te kete capital dhe asete te mjaftueshme per ushtrimin e aktivitetit dhe permbushjen e detyrimeve kundrejt te treteve;
- k) te hipotekoj, lere peng dhe vendosi cdo barre mbi asetet e veta, te lidhe cfaredo marreveshje financiare me cdo pale financuese me kusht qe hipoteka, pengu apo barret e tjera po ashtu si edhe marreveshjet perkatese financiare te sherbejne per permbushjen e detyrimeve te percaktuara ne nenin 4.1'
- l) Krijimin, mbylljen dhe /ose prishjen e degeve, zyrave te perfaqesimit dhe filialeve;
- m) Transferimin e aseteve te shoqerise sipas vleres qe mund te percaktohet ne momentin e transferimit;
- n) cdo ceshtje tjeter qe percaktohet nga ligji(et) I zbatueshem apo nga ky statut;

## 7.2 Thirrja e Asamblese

7.2.1. Administratoret, sipas gjykimit te tyre te lire ose me kerkesen e nje dhe /ose me shume Ortakeve te cilet perfaqesojne te pakten 5% te kapitalit te shoqerise dhe /ose eksperti kontabel I autorizuar, nese ka dhe /ose likujduesit kane te drejte te therrasin Asamblene e Pergjitheshme te Ortakeve. Ortakeve duhet tu dergohet nje njoftim me shkrim per mbledhjen me ane te postes se rregjistruar apo me email, jo me pak se 7 dite perpara dates se mbledhjes, qe permban te dhenat dhe arsyet e mbledhjes, vendin daten dhe oren e saj.

7.2.2. Verifikimi I njoftimit te mbledhjes nuk eshte I nevojshem nese te gjitha Ortaket jane te pranishem apo jane te perfaqesuar ne perputhje me nenin 7.2.1

7.2.3 Te gjitha vendimet e mara nga ortaku i vetem regjistroheshen ne nje rregjister te vendimeve ne te kundert ato jane absolutisht te pavlefshme.

## **Neni 8** **Administrimi i Shoqerise**

### **8.1 Funkcionet dhe kompetencat:**

8.1.1 Shoqeria do te administrohet nga Z. Ibrahim Elfakii cili do te qendroje ne detyre per nje afat 5 vjecar me te drejte rizgjedhje.

8.1.2 Administratori i vetem i Shoqerise ka te drejte dhe detyrohet te kryeje te gjitha veprimet e administrimit te veprimtarise tregtare te shoqerise . Ai ushtron te gjitha kopetencat sipas percaktimeve te neit 95 te ligjit 9901 date 14.04.2008 " Per tregtaret dhe shoqerite tregtare".

8.1.3 Administratori i shoqerise ka te drejte te emeroje perfaqesues te posacem dhe te delegoje kopetencat e tij.

8.1.4 Administratori i vetem i shoqerise eshte pergjegjes per administrimin frytdhenes te dobishem e te kujdesshem te shoqerise dhe te perfaqesoj shoqerine kundrejt paleve te treat ne lidhje me dhe ne perputhje me dispozitat e ketij statute dhe/ ose ligjit/vet e zbatueshem. Administratori ka koppelente te plote per administrimin e zakonshem ne perputhje me legjislacionin shqiptar ne fuqi dhe per administrimin e jashtezakonshem te shoqerise.

Administratori do te kete kompetenca dhe detyra qe te lidhen me administrimin dhe mbikqyrjen e aktivitetit te shoqerise, si me poshte vijon:

- a) Te mbikqyre dhe te zbatoje veprimtarite dhe politikat tregtare te shoqerise dhe vendimet e Asamblese se Ortakeve;
- b) Me kerkesen e asamblese se ortakeve te ndermari masa te cilat jane competence te kesaj te fundit, te propozoje vendimet qe do te miratohen nga Asambleja e ortakeve dhe ti zbatoje keto vendime;
- c) Te siguroje qe shoqeria respekton ligjet e zbatueshme dhe standartet kontabel;
- d) Te kryeje te gjitha veprimet ne lidhje me administrimin e aktivitetit tregtar te shoqerise;
- e) Te perfaqesoj shoqerine kundrejt paleve te treat;
- f) Te siguroje dokumentet dhe librat kontabel te shoqerise te mbahen ne rregull dhe me saktesi;
- g) Te therasi nje mbledhje te Asamblese se Pergjithsme kur e vlereson te nevojshme per mbrojtjen e interesave te shoqerise;
- h) Te pergatise dhe nenshkruaje pasqyrat financiare vjetore te shoqerise, pasqyrat financiare te konsoliduara , te cilat bashke me propozimin per shperndarjen e fitimit I paraqiten per miratim Asamblese se ortakeve;



- i) Te kryeje te gjitha rregjistrimet dhe publikimet e detyrueshme ne lidhje me shoqerine, sipas parashikimeve te ligjit te zbatueshem;
- j) Te miratoje hapjen e cdo procedure ligjore ose mbylljen e tyre;

8.1.5 Administratori mund te ushtroje te gjitha kompetencat e shoqerise si dhe te kryeje te gjitha veprimet qe me ligj ose per arsye te tjera jane competence e tij.

#### 8.2 Pergjegjesite:

Administratori eshte pergjegjes kundrejt shoqerise dhe /ose paleve te treat per demet e shkaktuara nga shkelja e dispozitave te ligjeve te zbatueshme.

### **Neni 9**

#### **Ekspert (et) kontabel te Autorizuar**

Ekspertet kontabel te Autorizuar do te emerohet(n) me vendim te Asamblese se Ortakeve, ne rastet kur parashikohet ne legjislacionin shqiptar. Riemerimi I ekspertit (ve) kontabel te autorizuar do te behet ne perputhje me legjislacionin shqiptar ne fuqi. Eksperti (ekspertet kontabel te autorizuar mund te shkarkohen me vendim te asamblese se pergjithshme te ortakeve ne rast shkelje te detyrave, gabimeve dhe sjellje jot e mira profesionale.

### **Neni 10**

#### **Viti Ushtrimor**

Viti ushtrimor fillon me 1 Janar dhe mbaron me 31 Dhjetor te cdo viti kalendarik.

Perjashtimisht, viti i pare ushtrimor fillon ne daten e rregjistrimit te shoqerise ne rregjistrin tregtar shqiptar dhe perfundon ne 31 Dhjetor te vitit te themelimit.

### **Neni 11**

#### **Shperndarja dhe prishja**

##### **11.1 shoqeria priset:**

- a) Me vendim te Ortakut te vetem;
- b) me hapjen e procedurave te falimentit;
- c) nese nuk ka kryer veprimtari tregtare per dy vjet dhe nuk eshte njoftuar pezullimi i veprimtarise ne perputhje me piken 3 te nenit 43 te ligjit 9723 date 3.5.2007 "Per qendren kombetare te regjistrimit"
- d) me vendim gjykate;
- e) per shkaqe te tjera ligjore;



**Neni 12**  
**Ligji i zbatueshem**

12.1 Shoqeria do te zhvilloje aktivitetin e saj ne perputhje te plote me kete statut dhe me dispozitat e ligjeve shqiptare te zbatueshme

12.2 Ligji shqiptar per shoqerte tregtare do te aplikohet per te gjitha aspektet te cilat nuk jane te rregulluara nga ky statut.

Per cdo aspekt apo ngjarje qe nuk percaktohet nga ky Statut do te aplikohen dispozitat e ligjit shqiptar 9901 date 14.04.2008 " Per tregtaret dhe shoqerite tregtare".

**Neni 13**  
**Mosmarreveshjet**

Cdo mosmarreveshje qe mund te linde ne lidhje me zbatimin ose interpretimin e ketij satuti, si dhe cdo mosmarreveshje qe mund te linde midis shoqerise dhe paleve te treat do te zgjidhet nga gjykata shqiptare kompetente.

**Neni 14**  
**Ndryshimet**


Ky statut mund te ndryshohet, rishikohet dhe /ose shfuqizohet ose teresisht dhe te zevendesohet me nje statut te ri me vendimin e Ortakut te vetem Z. Ibrahim Elfaki.

Ky statut i shoqerise me pergjegjesi te kufizuar Tirana Business Consulting shpk hartohet ne 4 kopje origjinale, ne gjuhen shqipe dhe angleze , qe do te kene te njejten vlere secila.

Une noteri e ndihmen e perkthyeses Znj. Eniela Agolli, ia lexoj tekstin me ze te larte Z. Ibrahim Elfaki pasi e gjen ate ne perputhje me vullnetin e tij te plote e te lire, nenshkruan ne pranine time dhe une noteri e vertetoj jkete akt sipas ligjit sot me date 03.10.2018

**ORTAKU I VETEM**

**IBRAHIM ELFAKI**

*Ibrahim Elfaki*  


REPUBLIKA E SHQIPERISE  
DHOMA E NOTEREVE TIRANE  
NOTER: SAIMIR S. SHATKU  
STUDIO: SHESHI: "AVNI RUSTEMI"  
RRUGA: "HOXHA TAHSIN",  
TEL:042-2250583 DHE MOB:0672557851



NR. 1529 REP.

VËRTETIM NËNSHKRIMI

Sot, me daten 11.10. 2018 (dy mijë e tetëmbëdhjetë), në Zyren e Noterise Tirane, me seli në Sheshin: "Avni Rustemi", Rruga "Hoxha Tahsin", përpara meje Noterit **SAIMIR S. SHATKU**, u paraqit personalisht themeluesi i "**TIRANA BUSINESS CONSULTING**" SH.P.K., si me poshte vijon:

- **Z. IBRAHIM MOHAMED MAKI ELFAKI**, shtetas Sudanez, lindur në Khartoum, Sudan, me 06.09.1968, banues në Tiranë, madhor dhe me zotësi të plotë juridike për të vepruar, mbajtës i pasaportes sudaneze, me numër: **P02399858**.

i cili deklaroi përpara meje noterit se me vullnet të lire, të plote dhe të pavesuar ka hartuar në cilësinë e ortakut themelues jashtë zyres noteriale, statutin e shoqërisë në themelimin e sipër "**TIRANA BUSINESS CONSULTING**" SH.P.K. bashkelidhur këtij vërtetimi si dhe e nënshkroi ato personalisht në praninë time, noterit, pa asnjë rezervë.

Sa me sipër, unë Noteri vërtetoj rregullsinë dhe bazueshmërinë e hartimit në ligj të këtij akti si dhe autenticitetin e nënshkrimit, me cilësinë që me njëhëni 55 i Ligjit nr. 7829, datë 01.06.1994 "Për Noterine në Republikën e Shqipërisë" (i ndryshuar).

Taksa e Pullës  
U PAGUA

NOTER  
SAIMIR S. SHATKU

